



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2018

V E N D I M

**Nr. 29 , Datë 25 / 01 / 2018**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 91, datë 03.08.2017, të paraqitur nga subjekti ankues L.A, kundër Drejtorisë Rajonale të Punësimit, Berat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”<sup>1</sup>.

Institucioni i Komisionerit gjatë takimeve të zhvilluara në qytetin e Beratit, në kuadër të aktivitetit “Ditë të hapura”, ka administruar disa ankesa lidhur me sjelljen dhe trajtimin e personave të komunitetit Rom dhe Egjiptian nga ana e subjekteve publike dhe private në qytetin e Beratit. Një nga këto ankesa është në emër të shtetases L.A.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga L.A, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

L.A në formularin e ankesës deklaroi se: *“Jeton me djalin e saj 5 vjeç, nuk përfiton pension apo ndihmë ekonomike dhe ka probleme shëndetësore me syrin e majtë. Është paraqitur tek zyra e punës dhe i kanë ofruar punë si rrobaqepëse, punë të cilën nuk mund ta bëj pasi ka probleme me syrin. Ankuesja informon se mund të punojë në detyra të tjera por i ofrojnë punë vetëm si rrobaqepëse sepse e dinë që nuk e bën dot”*. Ankuesja kërkon nga Drejtoria Rajonale e Punësimit Berat që të punësohet.

Raca, është shkak për të cilin ligji nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të këtij ligji, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje, që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me racën. Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike,*

<sup>1</sup> Ankuesja i përket komunitetit rom.

*gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Me shkresën Nr. 794/1 prot, datë 28.08.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga ana e Drejtorisë Rajonale të Punësimit, Berat, lidhur me ankesën e bërë nga L.A, për punësimin e saj.

Me shkresën nr. 404/1 Prot, datë 05.09.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria Rajonale e Punësimit, Berat, informon se: “L.A për shkak të arsyeve të saja shëndetësore, kërkon të punojë vetëm si punëtore ndihmëse. Nga ana e zyrës do bëhen përpjekjet maksimale për punësimin e saj”.

Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr.132, datë 06.10.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “Për kryerjen e inspektimit në Drejtorinë Rajonale të Punësimit Berat”, inspektorët e KMD-së me datë 11.10.2017 u paraqitën pranë DRP Berat, me qëllim marrjen e informacionit dhe kryerjen e verifikimeve përkatëse, lidhur me ankesën e L.A.

Gjatë inspektimit, ishin të pranishëm E.Xh, E.A dhe A.B, të gjithë me detyrë, specialist shërbimesh pranë Drejtorisë Rajonale të Punësimit Berat.

Gjatë inspektimit E.A deklaroi se: “L.A në muajin Korrik 2017 ka pasur kontaktin e parë me zyrën e punës dhe ka marrë informacionin e përgjithshëm mbi shërbimin e punësimit. Në datë 14.09.2017 është regjistruar si punëkërkuese e papunë dhe është hapur kartela përkatëse. Gjatë kësaj periudhe i është ofruar punë si sanitare dhe punëtore ndihmëse, por i ka refuzuar këto punë për arsye të problemeve shëndetësore që ka dhe ka deklaruar se do bëjë ndërhyrje kirurgjikale për shëndetin dhe pastaj do punësohet. Në muajin Shtator 2017 kemi bërë verifikimin e të dhënave të L.A me qëllim hedhjen e të dhënave në sistem dhe rezultoi se, që nga Janari 2017, L.A ka qenë e punësuar në subjekte të ndryshme dhe për këtë shkak bazuar në ligjin nr.146/2015 “Për Punëkërkuësit e Papunë” nuk përfiton statusin si punëkërkuës i papunë”.

Nga verifikimet e kryera<sup>2</sup> në dokumentacionin e zyrës së punësimit Berat, rezultoi se, L.A ishte e regjistruar si punëkërkuese e papunë që nga data 14.09.2017. Formulari i punëkërkuësit në rubrikën: “Çregjistrimi i punëkërkuësit”, nuk ishte i plotësuar sipas parashikimeve të Nenit 4, pika 7 të ligjit nr.146, datë 17.12.2015 “Për Punëkërkuësit”.

<sup>2</sup> Referuar procesverbalit të inspektimit datë 11.10.2017.

Nga verifikimet e kryera nga ana e specialistëve të Drejtorisë Rajonale të Punësimit Berat në sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, rezulton se L.A për periudhën, Janar-Shkurt 2017 ka qenë e punësuar pranë kompanisë “Center Shqiptare” në periudhën Mars-Korrik 2017 ka qenë e punësuar pranë kompanisë “Ediana” sh.p.k dhe në periudhën Gusht 2017 ka qenë e punësuar pranë kompanisë “Mito By Caterina Firenze”.

**Pas vlerësimit të fakteve dhe provave të grumbulluara gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri vlerëson se:**

Procesi i regjistrimit të punëkërkesve në zyrat e punësimit rregullohet sipas përcaktimeve të ligjit nr.146, datë 17.12.2015 “Për punëkërkesit”. Në nenin 4, pika 1 të këtij ligji përcaktohet se: *“Zyra përkatëse e punësimit vlerëson dhe regjistron çdo person që është në moshë për punë, që është i aftë dhe i gatshëm për punë, i cili deklaron se nuk është në marrëdhënie pune apo i vetëpunësuar, dhe paraqitet, personalisht, në zyrën e punësimit, me qëllim që të kërkojë punë”*.

Referuar formularit të punëkërkesit,<sup>3</sup> vërtetohet se L.A, kërkon të punësohet në profesionin si punëtorë ndihmëse si dhe përshkruhet si person me aftësi të kufizuara në punë, pasi ka probleme me shikimin. Në këtë formular në informacionin e specialistit të shërbimit të punësimit, përshkruhet se L.A është paraqitur në zyrën e punësimit në datat 14.09.2017 dhe në datë 02.10.2017 dhe në kolonën: Informacion për shërbimet e ofruara, shkruhet: *“E papërshtatshme për ofertat, ka probleme me shikimin. U informua për ofertat e punës, iu ofrua punë te Hotel “Pasarela” si sanitare dhe ndihmëse dhe Restorant “Ago”, i refuzoi të dyja ofertat. Pretendon se ka probleme me shëndetin e do të operohet nga syri”*.

Bazuar në raportin e inspektimit dhe dokumentacionit vënë në dispozicion nga palët vërehet se nga ana e specialistëve të zyrës së punësimit, L.A i janë ofruar dy punë, sipas kërkesave të L.A, por që i ka refuzuar, ndërkohë që ankuesja deklaron se nga ana e specialistëve të zyrës së punës i është ofruar punë vetëm në profesionin si rrobaqepëse, punë të cilën nuk mund ta kryejë për shkak të gjendjes së saj shëndetësore.

Në nenin 4, pika 7 të ligjit nr.146, datë 17.12.2015 “Për Punëkërkesit”, përcaktohet se: *“Kundërshtimi, mospranimi apo refuzimi i vendeve të punës dhe i programeve të punësimit të ofruara konfirmohen nga punëkërkesi, me nënshkrimin e tij. Në rast se punëkërkesi refuzon nënshkrimin, specialisti i shërbimeve të punësimit vendos shënimin: “Punëkërkesi refuzon të nënshkruajë””*.

Referuar formularit të punëkërkesit të L.A, vërehet se, kundërshtimi, mospranimi apo refuzimi i vëndit të punës nuk është konfirmuar nga ana e L.A, dhe nga ana e specialistit të zyrës së punës nuk është vendosur shënimimi përkatës, mbi refuzimin e nënshkrimit nga ana e punëkërkesit.

<sup>3</sup> Formulari i punëkërkesit L.A datë 14.09.2017.

Komisioneri vlerëson se në bazë të nenit 7 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” sjellja diskriminuese mund të konsumohet si me veprim ashtu dhe me mosveprim. Mosveprimi i subjektit, Drejtoria Rajonale e Punësimit Berat në përputhje me parashikimet ligjore që garantojnë përshtatjen e ofertës për punë ka bërë që L.A, për shkak të racës të mos gëzojë në baza të barabarta me punëkërkuarit e tjerë të drejtën për t’u punësuar. Dështimi i institucionit, Drejtoria Rajonale e Punësimit Berat për të marrë masat efektive për të siguruar ofrimin e shërbimit të punësimit për L.A, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë sipas parashikimit të bërë në nenin 3/2 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në nenin 20, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” pika 1/a, përcaktohet ndalimi i diskriminimit në fushën e të mirave dhe shërbimeve, në të cilin shkruhet se: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji”.*

Në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 3, pika 1, diskriminimi përkufizohet si: *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Sipas nenit 3/2, të po këtij ligji përcaktohet si diskriminimi i drejtpërdrejtë: *“ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga të dhënat e vëna në dispozicion nga palët, vlerëson se veprimet e specialistëve të Drejtorisë Rajonale të Punësimit Berat, kanë krijuar baza për mohimin e barazisë ndaj L.A, për shkak të racës, dhe e kanë ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlerëson se veprimet e kryera nga Drejtoria Rajonale e Punësimit Berat, duke mos bërë të mundur ofrimin e mundësisë së punësimit të një punë të përshtatshme, për L.A, kanë qenë diskriminuese.

Referuar shkresës nr.404/1, datë 05.09.2017 dhe Procesverbalit të inspektimit datë 11.10.2017, në të cilat Drejtoria Rajonale e Punësimit Berat, informon se do bëhen përpjekjet maksimale për ofrimin e një vendi pune të përshtatshëm për punësimin e L.A, Komisioneri vlerëson se L.A duhet të paraqitet pranë zyrës së punësimit për të përfitur nga programet e punësimit.

## PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1/2, 7/1, 20/1/a, 32/1/a dhe c/ dhe nenin 33/10 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetases L.A për shkak të racës, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Punësimit Berat.
2. Në referim të pikës 1, Drejtoria Rajonale e Punësimit Berat, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të marrë masat për ofrimin e mundësisë së punësimit, në një punë të përshtatshme, për L.A, sipas parashikimeve ligjore.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Drejtoria Rajonale e Punësimit Berat, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i rekomandon subjektit ankues, që të paraqitet pranë Drejtorisë Rajonale të Punësimit Berat për të përfituar nga programet e punësimit.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

---

**KOMISIONERI**

(shkaku: raca)  
(fusha: punesim)